



Përmbledhje e Shkurtër e Politikave

Nxitja e Bashkëpunimit dhe e Vlerave të Përbashkëta: Një Vështrim rreth Gjashtë Tryezave të Rrumbullakëta të Komunitetit në Kosovë

I. Hyrje

Nga nëntori 2024 deri në korrik 2025, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), e mbështetur nga Fondi Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED), zhvilloi gjashtë tryeza të rrumbullakëta me komunitetet në komunat e [Kamenicës](#), [Graçanicës](#), [Vitisë](#), [Lipjanit](#), [Shtërpcës](#), dhe [Gjakovës](#). Këto forume mbledhën së bashku zyrtarë lokalë, të rinj, shoqërinë civile, përfaqësues të zbatimit të ligjit dhe anëtarë të komunitetit për të diskutuar mbi marrëdhëniet ndëretnike, sfidat e përbashkëta, rolin e dezinformimit dhe besimin social në nivel komunal ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Në mungesë të përparimit të bashkëpunimit në nivel politik, tryezat e rrumbullakëta u konceptuan për të fuqizuar zërat lokalë dhe për të ofruar njohuri mbi reformën institucionale dhe përfshirjen ndëretnike në Kosovë.

II. Gjetjet Kryesore

1. Marrëdhëniet ndëretnike: Të qëndrueshme, por nga aspekti strukturor të cenueshme

Në të gjitha komunat, pjesëmarrësit i përshkruan marrëdhëniet ndëretnike ndërpersonale si të forta, shpesh në kontrast me mënyrën se si situata mund të perceptohet në bazë të politikës kombëtare, konkretisht në dialogun zyrtar ndërmjet qeverive të Kosovës dhe Serbisë, i cili aktualisht është i bllokuar për shkak të disa rrethanave. Në fakt, siç vunë në dukje shumë pjesëmarrës, komunikimi në nivel lokal është mjaft pozitiv. Siç përmendi një pjesëmarrës në Komunën e Lipjanit: “Ne nuk i ndiejmë ndarjet këtu në Lipjan. Ne jetojmë së bashku, punojmë së bashku dhe ndihmojmë njëri-tjetrin,” deklaroi Zoran Stanojeviq, përfaqësues i

komunitetit serb. Po ashtu, në Komunën e Shtërpçës, zyrtari komunal Igor Saviq tha se: "Respekti për diversitetin është normë në Shtërpçë. Problemet me të cilat përballlemi nuk janë etnike – ato janë politike dhe strukturore." Pjesëmarrësit shtuan se ata janë më të shqetësuar për çështjet strukturore, të cilat shpesh vijnë si pasojë e implikimeve më të gjera politike. Shembuj të çështjeve strukturore përfshijnë sfida si vonesat në licencimin për mbledhjen e mbeturinave dhe moszgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth projekteve të infrastrukturës lokale, duke përfshirë protestat e qytetarëve kundër ndërtimit të planifikuar të hidrocentraleve të ujit, procesin e vonuar të nostrifikimit të diplomave nga Serbia, si dhe potencialin e pashfrytëzuar të të rinjve për të pasur qasje në punësim dhe mundësi arsimore të qëndrueshme. Qytetarët gjithashtu theksuan potencialin e paeksploruar të zonës turistike të Brezovicës dhe rolin në rënie të aktivizimit të shoqërisë civile, e cila mungon në mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e projekteve.

Komunat si Kamenica u përmendën gjithashtu shpesh si modele të bashkëjetesës, ku bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve shqiptare, serbe dhe rome është i integruar në jetën e përditshme. Një nga pjesëmarrësit vlerësoi historinë e bashkëpunimit ndëretnik në Kamenicë, duke përmendur shembullin e një tregu të fermerëve që mbështetet nga komuna, ku mblidhen të gjitha komunitetet. Një tjetër anëtarë e grupit mbështeti këtë pohim, duke përshkruar Kamenicën si një vend ku ndihet e sigurt, duke theksuar se kurrë nuk ka ndjerë pasiguri duke ecur vetëm edhe natën. Diskutimi gjithashtu preku edhe iniciativa të suksesshme, të tilla si projekti i dyqanit të luleve i iniciuar nga anëtarët e komunitetit rom, i përmendur nga pjesëmarrësit nga OJQ-ja "Luludi," i mbështetur nga BE-ja dhe Komuna e Kamenicës.

2. Sfidat e përbashkëta socio-ekonomike në të gjitha komunitetet

Pjesëmarrësit, në vend të ndarjeve etnike, identifikuan në mënyrë të vazhdueshme **papunësinë, migrimin e të rinjve dhe mungesën e perspektivave arsimore** si shqetësime kryesore. Për shembull, një nxënës i shkollës së mesme nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe punonjës i një OJQ-je në Kamenicë tha se: "Problemi i vërtetë këtu nuk është etnia – është mungesa e mundësive. Të rinjtë po largohen sepse nuk ka asgjë për ti bërë të qëndrojnë këtu." Në mënyrë të ngjashme, një mësues dhe artist vendor në Kamenicë mbështeti këtë shqetësim lidhur me barrierat socio-ekonomike, duke thënë se: "Papunësia na prek të gjithëve njësoj – serbët, shqiptarët, romët. Nuk është çështje etnie, ka të bëjë me mbijetesën." Pjesëmarrësit në Graçanicë theksuan **mosfunksionimin e granteve të sektorit privat**. Kur u pyetën për sfidat brenda komunës, pjesëmarrësit përmendën mungesën e mundësive për punësim, duke përmendur sektorin privat si një nga më të pazhvilluarit. Komuna e Graçanicës ofron grante për startup-e dhe biznese që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm.

Megjithatë, siç përmendi një pjesëmarrës dhe punonjës komunal, njerëzit thjesht aplikojnë për grante dhe rrallë bëjnë punën që kërkohet më pas. Sektori privat është thellësisht i pazhvilluar, ndërsa sektori publik nuk ka kapacitet të punësojë të gjithë. Një pjesëmarrës, i cili punon si bletar, për shembull, përshkroi interesin e kufizuar të njerëzve për të punuar në fusha jashtë mjekësisë ose arsimit. Në komunën e Gjakovës, nga ana tjetër, pjesëmarrësit bënë thirrje për **integrim ekonomik nga poshtë-lart të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**, përmes mbështetjes së bizneseve dhe shërbimeve publike. Megjithatë, pavarësisht përparimeve, si përmes përfshirjes shoqërore të të rinjve RAE, të cilët vërejtën se më shumë se 100 biznese të menaxhuara nga anëtarë të komunitetit RAE tashmë funksionojnë në qendër të Gjakovës – një shenjë progresi dhe pjesëmarrjeje në jetën publike – një sfidë që vazhdon të ekzistojë në Gjakovë është përmirësimi i ngadalshëm i dialogut ndërmjet komuniteteve.

3. Dezinformimi si mjet për dëmtimin e marrëdhënieve ndëretnike

Roli i **dezinformimit** u shfaq si një shqetësim që prek të gjitha komunitetet në të gjithë sektorët. Edhe pse ekzistojnë faktorë të tjerë që kontribuojnë në këtë atmosferë, në pothuajse të gjitha komunat, përhapja e dezinformimit u identifikua si një faktor kyç që synon të mbajë frikën tek popullata. Një gazetar nga Gjilani përmendi në tryezën e rumbullakët të Kamenicës se: “Lajmet e rreme manipulojnë të kaluarën tonë dhe mbajnë gjallë urrejtjen. Njerëzit nuk i kontrollojnë faktet, përkundrazi besojnë atë që i përshtatet frikës së tyre.” Në mënyrë të ngjashme, një pjesëmarrës komunal nga Graçanica përmendi se dezinformimi dhe lajmet që tentojnë të nxisin frikë godasin pjesën më të **cenueshme të shoqërisë**, që shpesh përfshin të moshuarit. “Të moshuarit lexojnë diçka online dhe e besojnë menjëherë. Kështu përhapet ndarja,” vuri në dukje pjesëmarrësi.

Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte pengesa gjuhësore – duke qenë se shumica e pjesëmarrësve nuk flasin gjuhët e njëri-tjetrit, konkretisht shqip dhe serbisht, shoqëritë mbeten të cenueshme: së pari, për shkak të mungesës së mundësive për të komunikuar direkt, dhe së dyti, duke qenë më të prirura për keqkuptimin e ngjarjeve që ndodhin në të gjithë Kosovën. Pjesëmarrësit e lidhën dezinformimin me nivelin e ulët të njohurive mediatike, një ambient mediatik të polarizuar dhe mungesën e dialogut ndërmjet komuniteteve, **duke përforcuar stereotipet dhe thelluar mosbesimin.**

4. Shoqëria civile dhe institucionet publike: Të besueshme por me burime të kufizuara

Institucionet publike, veçanërisht policia, zjarrfikësit dhe shërbimet shëndetësore, u perceptuan kryesisht si neutrale dhe të drejta. “Ne kurrë nuk i shikojmë bazuar në etni kur përgjigjemi. Kjo nuk bën pjesë të punës tonë, dhe njerëzit na besojnë për këtë,” vuri në dukje një zjarrfikës në Viti. Në fakt, kishte një konsensus të përgjithshëm se sa i përket shërbimeve publike, Zyrat për Komunitete dhe institucionet e tjera relevante në nivel komunal i përgjigjen nevojave dhe kërkesave të të gjithë anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, ekziston nevoja për një fushatë më të madhe nga institucionet publike për të informuar qytetarët mbi pikat e kontaktit ku mund të adresojnë shqetësimet e tyre. Prandaj, është e nevojshme, **një komunikim publik më i fortë nga lart-poshtë** nga autoritetet komunale.

Në të gjitha komunat, pjesëmarrësit dukeshin mirë të integruar në temën e bashkëpunimit ndëretnik për shkak të disa aktiviteteve që janë organizuar gjatë viteve nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Këto aktivitete kanë ndihmuar në mbledhjen e të gjitha komuniteteve dhe trajtimin e çështjeve dhe temave si pajtimi, bashkëpunimi socio-kulturor, zhvillimi socio-ekonomik dhe të tjera. Megjithatë, pjesëmarrësit në Shtërpçë dhe Gjakovë ngritën shqetësim për **zvogëlimin e mbështetjes nga donatorët dhe hapësirën e ngushtë për angazhimin afatgjatë të shoqërisë civile.** “Donatorët vijnë e shkojnë, por problemet mbeten. Na nevojiten projekte që zgjasin më shumë se një vit,” theksoi një përfaqësues i OSHC-ve nga Shtërpça.

5. Më shumë shembuj të rasteve pozitive

Duke u mbështetur në gjetjet lidhur me ndikimin e dezinformimit në nxitjen e frikës dhe tensionit në marrëdhëniet ndëretnike, një aspekt tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me rolin e mediave në formësimin e perceptimeve. Diskutimet nëpër komunë treguan se **shembujt pozitivë të bashkëpunimit ndëretnik rrallë**

herë theksohen në mediat kryesore, si televizionet, portalet e lajmeve dhe kanalet e tjera të komunikimit. Rritja e dukshmërisë së këtyre rasteve mund të kontribuojë në krijimin e një narrative më konstruktive dhe promovimin e mirëkuptimit ndëretnik. Gjithashtu, kjo do t'u lejonte edhe komuniteteve më të polarizuara të mësonin nga praktikat e suksesshme, duke ndihmuar në normalizimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjellë. Për shembull, në Komunën e Lipjanit, një përfaqësues i policisë lokale ndau një rast ku një grua e moshuar serbe hezitonte të përdorte shërbimet sociale për shkak të shqetësimeve lidhur me dokumentacionin. Një përfaqësues i komunitetit serb të Kosovës nga komuna e ndihmoi atë, duke i dhënë udhëzimet e nevojshme, dhe si rezultat, ajo tani merr rregullisht pensionin e saj. Në mënyrë të ngjashme, në Viti, përfaqësuesit e spitalit lokal përshkruan se si shërbimet shëndetësore ofrohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, me infermierë serbë të Kosovës që punojnë aktivisht në institucion dhe ruajnë komunikim të ngushtë me komunitetin.

6. Përballja me të kaluarën: Një pengesë e pazgjidhur

Pavarësisht diskutimeve mbi çështjet strukturore, socio-ekonomike dhe politike, një çështje komplekse mbetet trashëgimia e luftërave të viteve 1990, e cila vazhdon të formësojë perceptimet. "Disa nga zërat më nacionalistë janë të rinj që nuk e kanë përjetuar kurrë luftën. Nuk është përvojë, është trashëgimi", tha Agnesa, studente e sociologjisë në diskutimin në tryezën e rumbullakët në Graçanicë. Në komuna të tjera, si në Lipjan, pjesëmarrësit theksuan se në fillimet e pasluftës, kishte më pak komunikim, por përfundimisht, qytetarët filluan të (ri)ndërtonin marrëdhëniet e tyre. Pavarësisht kësaj, pjesëmarrësit ranë dakord se dialogu konstruktiv historik është thelbësor për pajtimin. "**Injorimi i së kaluarës vetëm sa i jep asaj më shumë fuqi. Ne duhet të flasim për të, por në mënyrën e duhur, jo për të nxitur urrejtje,**" tha një pjesëmarrës i ri gjatë diskutimit në Kamenicë.

III. Politikat e Sugjeruara

Duke u bazuar në gjetjet e mësipërme, janë shtruar edhe disa rekomandime që pjesëmarrësit paraqitën. Disa nga këto rekomandime përfshijnë si vijon:

- ✓ **Politika e sugjeruar 1:** Zyrtarët e lartë shtetërorë duhet të organizojnë diskutime të hapura në komunat multietnike për të angazhuar drejtpërdrejt qytetarët mbi sfidat dhe për të promovuar bashkëpunim dhe mirëkuptim më të madh.
- ✓ **Politika e sugjeruar 2:** Institucionet publike duhet të investojnë më shumë në zgjidhjen e çështjeve me shqetësim të përbashkët si për shqiptarët ashtu edhe për serbët në komunat e përziera.
- ✓ **Politika e sugjeruar 3:** Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthime duhet të përmirësohen për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të të rinjve në komunat multietnike.

- ✓ **Politika e sugjeruar 4:** Investimi në programe shkëmbimi ndëretnik, veçanërisht midis nxënësve të shkollave të mesme në Kosovë.

IV. Si të Vazhdojmë Tutje?

Komunitetet lokale të Kosovës kanë treguar se paqja ndëretnike është e mundur dhe e pranishme. Megjithatë, jeta e përditshme formësohet më pak nga etnia sesa nga sfidat sistemike, siç janë ngecja ekonomike, mosveprimi politik dhe dezinformimi. Ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse kërkon investime të synuara në rini, arsim, shoqëri civile dhe iniciativa për ndërtimin e besimit. Institucionet dhe donatorët duhet të harmonizojnë përpjekjet me atë që zërat lokalë kërkojnë qartë: mundësi, drejtësi dhe përfshirje kuptimplotë. QKSS do të vazhdojë punën e saj për të ngritur perspektivat e komunitetit dhe për të siguruar që dialogu i bazuar në prova të mbetet qendror për të ardhmen demokratike të Kosovës.

V. Shënim

Kjo publikim është pjesë e projektit Promovimi i Transparencës dhe Llogaridhënies Qeveritare në Dialogun Ndëretnik, i mbështetur bujarisht nga National Endowment for Democracy (NED). Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED-it